



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:111322  
Datë: 02.04.2024  
Numri i dokumentit: 05532300

**C.nr. 596/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** përmes gjyqtarit G.A, me bashkëpunëtorin profesional B. S, në çështjen kontestimore të paditësit R. H nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F. A avokat nga Gjilani, ndaj të paditurës Q. e R. së Kosovës, M. e B., P. dhe Zh. R.-Agjencia P. e Kosovës, adresa Rruga, "H.M", nr.10, Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes së shqyrtimit përgatitor dhe publik, 25.03.2024, ndersa më datën 02.01.2024, mori këtë,

**A K T V E N D I M**

**I.**Padia e paditësit R. H nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F. A avokat nga Gjilani, ndaj të paditurës Q. e R. së Kosovës, M. e B., P. dhe Zh. R.-Agjencia P. e Kosovës, adresa Rruga, "H.M", nr.10, Prishtinë, **KONSIDEROHET e tërhequr**, për shkak të mungesës së përfaqësuesit të palës paditëse, i cili është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 25.03.2024, ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt, por mosardhjen nuk e ka arsyetuar.

**II.**Secila palë ti bart vet shpensimet e procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi R.H nga Gjilani, në këtë gjykatë më datë 31.05.2022, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Q. e R. së Kosovës, M. e B., P. dhe Zh. R.-Agjencia P. e Kosovës, adresa Rruga, "H.M", nr.10, Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material.

Lidhje me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka caktuar seancë gjyqësore për datën 25.03.2024, në ora 13:30h, për të cilën seancë pala paditëse përkatësisht i autorizuari i tij av.F.A dhe i padituri kanë qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për seancë nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata duke e pasur parasysh se pala paditëse përkatësisht i autorizuari i tij av.F. A, ka munguar në seancën e shqyrtimi gjyqësor edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, e cila

dëshmohet përmes ftesës së dorëzimit personal për datën dhe orën e cekur si më lartë, e për të cilën seancë mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.”*, gjykata e konsideroj të tërhequr padinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për shpenzimet e procedurës gjykata vendosi sipas nenit 450 të LPK.

Nga të lartëcekurat, e konform nenit 409 paragrafi 1, dhe 142 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK-së), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 596/2022, datë 02.04.2024**

**Gjyqtari,**  
**G. A**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate